

BASHKËPUNIMI GJAKOVË-PARDUBICE (ÇEKI) MOSTËR PËR TË TJERËT

Si të joshen investimet e huaja?

Investimet e drejtpërdrejta ndërkombëtare, rruga më e mirë e nxitjes së zhvillimit ekonomik në Kosovë, është thënë në një seminar ndërkombëtar që dje u mbajt në Gjakovë

Gjakovë, 28 shtator

Tashmë është plotësisht e qartë se për një zhvillim më të shpejtë të Kosovës, janë të domosdoshme investimet e huaja, të cilat mund të bëhen në forma të ndryshme, por me efektivet janë ato që bëhen drejtpërdrejt. Çështja e gjetjes së rrugës për joshjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, ishte temë debati në seminarin ndërkombëtar që sot u mbajt në Gjakovë, ku, pos përfaqësuesve të disa komunave të Kosovës, merrnin pjesë edhe zyrtarët nga Ambasada e Çekisë në Prishtinë, zyrtarët e



Ministrit së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) të Kosovës dhe përfaqësuesit e Komunës së Pardubices në Çeki, e cila tashmë ka vënë lidhje shumë të mira të bashkëpunimit me Gjakovën. Ky seminar i titulluar "Zhvillimi i vazhdueshëm në komunat e Kosovës" u organizua në kuadër të projektit "Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të Gjakovës".

Bashkëpunimi si mostër

Jan Plesinger, zv.ambasador i Çekisë

në Kosovë tha se bashkëpunimi ndërmjet Gjakovës dhe Pardubices është i rëndësishëm të posaçme, jo vetëm për faktin se nga ky bashkëpunim do të përfitojnë gjakovarët, por, mbase dhe më shumë për shkak se ai mund të shërbejë si mostër për vënien e bazës për hartimin e një strategjie të zhvillimit ekonomik, strategji kjo që premtom sigurimin e investimeve të drejtpërdrejta nga jashtë jo vetëm për Gjakovën, por edhe për komunat e tjera të Kosovës.

Pardubice, komunë e industrializuar

Eksperti çek i ekonomisë, Dabid Kopic, i cili mori disa shembuj konkretë të efekteve të bashkëpunimit ekonomik, tha se Pardubice nuk është zgjedhur rastësisht, pasi është një ndër komunat më të industrializuara në Çeki dhe e ka shkallën e punësimit madje rreth 97%.

Vërtet është ky bashkëpunimi i parë ndërmjet një komune kosovare dhe një nga Çekia, por jam i bindur se nuk do të jetë i fundit" ka thënë Plesinger, duke shtuar se ky bashkëpunim mund t'i tërheqë për investime jo vetëm kompanitë çeke, por edhe të tjera nga vende të tjera evropiane.

"Ky bashkëpunim ndërmjet Gjakovës dhe Pardubices dhe të tjerët që premtohen në të ardhmen, janë dëshmi se kjo mbështetje po shtrihet edhe në proceset e zhvillimit ekonomik", është shprehur Pal Lekaj, kryetar i Gjakovës, duke iu falënderuar çekëve për ndihmën e dhënë.

B.VULA